



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

**Nr. i Dokumentit: 23.6a.1-2017-08**

## **RAPORTI I AUDITIMIT**

**PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË AEROPORTIT TË  
GJAKOVËS SH.A PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR  
2017**

**Prishtinë, qershor 2018**

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ndërmarrjes Qendrore Publike Aeroporti i Gjakovës Sh.A, në konsultim me Ndihmës Auditoren e Përgjithshme *Vlora Spanca*, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga udhëheqësi i ekipit *Bahri Statovci dhe anëtarja e ekipit Valbona Pllana*, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit *Enver Boqolli*.

---

## TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme .....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit .....	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm .....	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli .....	11
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	19
5 Qeverisja.....	20
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA .....	24
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme .....	27
Shtojca III: Letër konfirmimi .....	29

## Përmbledhje e përgjithshme

### Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Ndërmarrjes Qendrore Publike Aeroporti i Gjakovës sh.a për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 13.09.2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar bazuar në cilësinë dhe efektivitetin e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Aeroportit të Gjakovës.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e Aeroportit të Gjakovës për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.


### Opinionit i Auditorit të Përgjithshëm

#### Mohim i opinionit

Për shkak të mungesës së dëshmive të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, ne nuk ishim në gjendje të japim opinion për PFV-të e vitit 2017.

Për më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

**Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore**

Kryeshefi Ekzekutiv është pajtuar me të gjeturat dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

# 1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

## Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë për kryerjen e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Aeroportit të Gjakovës (tutje Aeroporti). Ne kemi analizuar veprimtarinë e ndërmarrjes se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP-së).

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontroleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

## 2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

### Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV-ve) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. PFV-të përgatiten dhe nënshkruhen nga Zyrtari Kryesor Financiar i Thesarit (ZKFTH) dhe Krye shefi Ekzekutiv (KE) dhe dorëzohen për miratim në Bordin e Drejtorëve (BD).

Miratimi i PFV-ve përfshin një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë aksionarit dhe publikut të gjerë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

### 2.1 Opinioni i auditimit

#### Mohim i opinionit

- Ne ishim angazhuar për auditimin e pasqyrave financiare vjetore të Aeroportit të Gjakovës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozitës financiare, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e rrjedhës së parasë, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe shënimet shpjeguese.
- Për shkak të rëndësisë së çështjeve të përshkruara në paragrafin e bazës për refuzimin e dhënies së opinionit, ne nuk ishim në gjendje të sigurojmë evidencën e nevojshme të auditimit për të pasur një bazë për një opinion të auditimit. Prandaj, ne nuk shprehim një opinion për këto pasqyrat financiare.

#### Baza për mohim të opinionit

Ne nuk ishim në gjendje të shprehim një opinion, për arsyen e përmendur në vijim:

- Aeroporti në pasqyrën e pozitës financiare në zërin “ndërtesat” ka prezantuar vlerën 8,241,374€, ndërsa në analitiken e këtij zëri ka një listë me 405 artikuj, ku 118 prej tyre janë të prezantuara pa asnjë vlerë. Për këto pasuri nuk kishte një plan të zhvlerësimit. Po ashtu në këtë zë ishin përfshirë gabimisht makineri & pajisje të rënda dhe automjetet, rrjedhimisht edhe normat e zhvlerësimit nuk ishin përdorur ashtu siç ishin të përcaktuara me politikat e kompanisë (për makineri & pajisje të rënda me 10% dhe automjete me 20%), por ishin zhvlerësuar të gjitha më normën 5%. Kjo ka shkaktuar mbivlerësimin e zërit të “ndërtesave” dhe nënvlerësimin e zërit “makineri & pajisje të rënda dhe automjetet”, po ashtu edhe nënvlerësimin e shpenzimeve të zhvlerësimit dhe të hyrave nga grantet. Ne nuk ishim në

---

gjendje të bëjmë klasifikimin dhe matjen e këtyre pasurive se cilat duhej të zhvlerësoheshim me 10% apo me 20% për ta matur efektin e keq prezantimit.

- Si pasojë e mungesës së dëshmive adekuate për të konfirmuar vlerën e zërit të ndërtesave që është me vlerë materiale në raport me të gjithë zërat tjerë në PFV, ne nuk jemi në gjendje të japim opinion për këto pasqyra financiare.

### **Çështjet kyçe të auditimit**

Aeroporti ende nuk krijon të hyra nga veprimtaria e vetë, por të gjitha të hyrat i ka nga aksionari (Qeveria e Kosovës) në forme të subvencionit me të cilat i mbulon shpenzimet e veta. Po ashtu, Aeroporti disponon me 146 hektar tokë (104 hektar pronë publike dhe 42 hektar pronë private) të cilat i ka në shfrytëzim dhe menaxhim që nga themelimi, respektivisht nga 18.12.2013 kur është bërë dorëzim/pranim nga KFOR-i Italian te Qeveria e Kosovës. Mirëpo, tani kanë disa pretendues të tokave dhe për këtë Aeroporti ka kërkuar nga aksionari të filloj një proces të shpronësimeve për këto raste. Aeroporti për këto shqetësime të saj është në pritje të përgjigjes nga aksionari (Qeveria e Kosovës).

### **Çështje Të tjera**

Pasqyrat financiare vjetore të ndërmarrjes për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2016 janë audituar nga një kompani private e auditimit, e cila kishte refuzuar të japë opinion, për shkak se kompania nuk kishte përgatitur pasqyrat financiare në pajtim me standardin ndërkombëtar të raportimit financiar për njësit e vogla dhe të mesme të botuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit. Evidencat janë udhëhequr në një bazë të Exel-it dhe nuk janë bërë regjistrimet e dyfishta.

### **Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës për qeverisje dhe PFV-të**

Kryesuesi i Bordit të ndërmarrjes është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare në bazë të parimit aktual sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK), Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe Ligjet e Kosovës, si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keq deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshin zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe ligjin nr. 04/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime).

Kryesuesi i Bordit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të ndërmarrjes.

### **Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve**

Objektivat tona janë që të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare vjetore në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë nga mashtrimi ose gabimi, dhe të japim një opinion të

---



---

auditimit. Megjithatë, për shkak të çështjeve që janë përshkruar në paragrafin e bazës për refuzimin e opinionit, ne nuk ishim në gjendje të sigurojmë evidencën e nevojshme të auditimit që të na jepte një bazë për opinionin e auditimit.

## 2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

NP kërkohet të veproj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Kërkesat e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime);
- Kërkesat e Ligjit nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare;
- Kërkesat e Ligjit nr. 04/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime);
- Kërkesat e Ligjit nr.04/L-014 për Kontabilitet, Raportim Financiare dhe Auditim;
- Kërkesat e Ligjit të Prokurimit Publik ( me ndryshime dhe plotësime);
- Kërkesat e Udhëzimit nr. 2/2013/MF për Strukturën dhe Përmbajtjen e Raporteve Financiare Vjetore; dhe
- Nga NP-të, po ashtu kërkohet të përgatisë raportet si në vijim:
  - Statuti i NP-së;
  - Plani i biznesit;
  - Raporte tremujore;
  - Raporte vjetore;
  - Raportin nga matja e kënaqshmërisë së Konsumatorëve; dhe
  - Draft plani dhe plani përfundimtar i prokurimit me kohë.

Në draft PFV-të ishin të nevojshme disa korrigjime financiare në bilancin e gjendjes, pasqyrën e rrjedhës së parasë dhe shënimet shpjeguese që ishin përcjellë me gabime materiale. Përkundër sugjerimeve tona për ti bërë veprimet e nevojshme, Aeroporti kishte bërë disa korrigjime. Si pasojë e kësaj ne kemi identifikuar të gjeturat të cilat i kemi prezantuar tek baza për opinion.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, PFV-të e përgatitura nga KE dhe ZKFTH, nuk mund të konsiderohen të sakëta për shkak se gjatë auditimit janë identifikuar gabime materiale.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, kemi identifikuar mos-pajtueshmëritë si në vijim:

Sipas nenit 31 të Ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike raporti vjetor dhe raportet tremujore brenda 30 ditëve pas pranimit të raportit vjetor dhe raporteve tremujore BD do të shqyrtojnë ndryshojë dhe siç e sheh të arsyeshme ti miratojë; dhe

Raportet e dy tremujorëve të fundit të vitit 2017 të Aeroportit dhe raporti vjetor 2017, ishin përpiluar dhe dorëzuar brenda afateve kohore nga menaxhmenti i Aeroportit në Njësinë për Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike të paaprovuara nga BD. Kjo për shkak se katër anëtarë e BD ishin shkarkuar me vendimin e datës 29.09.2017 dhe (deri me datën 30.05.2018 përfundimi i auditimit) ende BD nuk ishte i kompletuar.

## 2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

**Rekomandimi 1** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se është bërë një analizë gjithëpërfshirëse për t'i përcaktuar shkaqet për mohim të opinionit të auditimit dhe të merren të gjitha veprimet që çështjet të cilat ndikuan të korrigohen dhe të mos përsëriten.

Gjithashtu, Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2018 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë, raportet tremujore, raportet vjetore. Kjo gjithashtu duhet të përfshijë rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe në fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. Nënshkrimi i pasqyrave nga KE dhe ZKFTH, nuk duhet të bëhet përveç nëse ndaj PFV-ve janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme para se të njëjtat t'i dorëzohen BD-ës.

## 3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

### Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e pranimi të subvencioneve nga aksionari (qeveria) dhe shpenzimeve në Aeroport. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i pranimi të subvencioneve, shpenzimeve, pasurive dhe detyrimeve.

### Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Kontrollet mbi menaxhimin e përgjithshëm të Aeroportit ishin të pamjaftueshme dhe kanë nevojë për përmirësime. Mungesa e strategjisë si një sistem efektiv i kontrollit të brendshëm ndikon në mos efektivitetin e planit operativ dhe financiar të Aeroportit dhe shkakton vonesa në funksionalizimin e tij.

Për më shumë, Aeroporti nuk kishte nxjerr rregullore për menaxhimin dhe ruajtjen e pasurive nga humbjet dhe dëmtimi i tyre. Si pasojë, kishin ndodhur vjedhje dhe dëmtime të aseteve që ishin në posedim të Aeroportit. Kjo për shkak të masave të pamjaftueshme të kontrollit të brendshme në ruajtjen dhe sigurimin e aseteve të Aeroportit. Po ashtu edhe mbajtja e evidencave të pasurive në Excel rritë rrezikun e humbjes së evidencave të pasurive dhe ndërhyrjeve të paautorizuara duke e rrezikuar pasurinë dhe vlerën e tyre.

Gjithashtu proceset e rekrutimit të punonjësve kanë nevojë të përmirësohen. Komisioni i rekrutimit i themeluar jo në përputhje me udhëzimin administrativ dhe vazhdimi i procesit të rekrutimit pa plotësimin e kriterëve të konkursit së paku nga tre kandidat rrezikon të punësoj punonjës jo kompetent për atë vend pune.

### 3.1 Plani i biznesit (të hyra dhe shpenzimet)

Ne i kemi shqyrtuar burimet e të hyrave dhe shpenzimeve të planifikuara me planin vjetor të biznesit për Aeroportin sipas kategorive përkatëse. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme.

**Tabela 1. Tabela e të hyrave dhe shpenzimeve sipas planit vjetor për vitin 2017 (në €)**

Përshkrimi	Planifikimi fillestar 2017	Plani përfundimtar 2017	Realizimi 2017	Realizimi 2016
Të hyrat nga subvencionet	653,068	653,068	175,288	201,423
Të hyrat nga granatet	-	-	504,532	504,465
Të hyra të jashtëzakonshme	-	-	542	-
<b>Gjithsej të hyrat</b>	<b>653,068</b>	<b>653,068</b>	<b>680,362</b>	<b>705,888</b>
Shpenzimet për paga mëditje dhe kontribute	261,768	261,768	126,871	124,358
Shpenzimet e zhvlerësimit	-	-	504,465	506,536
Shpenzimet tjera operative	391,300	391,300	49,026	74,994
<b>Gjithsej shpenzimet</b>	<b>653,068</b>	<b>653,068</b>	<b>680,362</b>	<b>705,888</b>

Planifikimi dhe realizimi i të hyrave dhe shpenzimeve ishin si në vijim:

- Ndërmarrja kishte planifikuar të pranoj nga aksionari buxhetin në vlerë 653,068€, ndërsa vetëm 200,000€ ju kishin ndarë si subvencion për mbulimin e të gjitha shpenzimeve për vitin 2017, përveç këtyre ndërmarrja i kishte edhe 69,424€ të bartura nga viti i kaluar. Këto diferenca ishin për shkak të mos ndarjes së mjeteve të planifikuara nga aksionari;
- Për paga dhe mëditje përfshirë edhe kontributet pensionale kishte shpenzuar 126,871€ kundrejt 261,768€ të planifikuara, respektivisht rreth 48%;
- Shpenzimet tjera operative për vitin aktual ishin realizuar në vlerë prej 49,026€ nga 391,300€ të planifikuara apo vetëm 12% e tyre; dhe
- Shpenzimet e zhvlerësimit ishin në shumën 504,465€ që kanë të bëjnë me pasuritë e pranuar si donacion, të cilat njihen si të hyrat nga grantet në momentin e zhvlerësimit të tyre.

**Çështja 2 – Mos hartimi i strategjisë së ndërmarrjes**

- E gjetura** Sipas nenit 14.2.2. të statutit të Aeroporti, BD është përgjegjës të përgatisë, të përcaktojë dhe miratojë strategjinë afatgjate të ndërmarrjes dhe së paku çdo tre muaj të rishikojë atë.
- Aeroporti nuk kishte hartuar strategjinë e cila do të ofronte mbështetje për procesin e planifikimit operativ dhe do të lehtësonte monitorimin drejt arritjes së rezultatit të synuar. Mos definimi i veprimtarisë për funksionalizim të Aeroporti, mungesa e fondeve dhe ekspertizës së duhur të veprimtarisë kanë ndikuar në vonesat për fillimin e përpilimit të planit strategjik.
- Rreziku** Mos hartimi i strategjisë si një sistem efektiv i kontrollit të brendshëm ndikon në efektivitetin e planit operativ dhe financiar të Aeroporti dhe shkakton vonesa në funksionalizimin e tij.
- Rekomandimi 2** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që janë ndërmarr veprime për hartimin dhe miratimin e strategjisë së ndërmarrjes dhe të bëjë përcjelljen e objektivave strategjike dhe zbatimin e tyre.

**3.2 Pasqyra e pozitës financiare (Bilanci i gjendjes)**

Ne kemi bërë auditimin e bilancit të gjendjes, duke i testuar edhe gjendjet e llogarive, por edhe transaksionet e ndodhura gjatë vitit në kuadër të këtyre llogarive. Përveç ekzaminimeve të gjendjes kontabël të llogarive, ne kemi trajtuar edhe aspektet e pajtueshmërisë me ligjet dhe rregulloret dhe kemi dhënë rekomandimet si më poshtë.

**Tabela 2: Pasqyra e pozitës financiare e Aeroportit të Gjakovës më 31 dhjetor 2017 në €**

Pasuritë	Viti 2017	Viti 2016	Detyrimet dhe Ekuiteti	Viti 2017	Viti 2016
Paratë në bankë dhe arkë	63,556	69,545	Llogarite e pagueshme tregtare	4,028	-
Stoqet	437,711	417,590	Detyrime tatimore	1,540	1,715
Parapagime	19,858	12,034	Detyrime për paga	(22)	-
Toka	-	-	Detyrime afatgjata	8,798,729	9,303,262
Ndërtesat	8,241,374	8,699,228	Të hyrat e shtyra nga subvencionet	79,577	54,865
Pajisjet	145,929	186,445	Kapitali themelues	25,000	25,000
Investime në vijim	424	-	Kapitali rezerve	-	-
<b>Gjithsej pasuritë</b>	<b>8,908,852</b>	<b>9,384,842</b>	<b>Gjithsej detyrimet dhe ekuiteti</b>	<b>8,908,852</b>	<b>9,384,842</b>

**Rekomandimi**

Nuk kemi rekomandime për këtë fushë.

**3.3 Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve**

Aeroporti në pasqyrën vijuese ka prezantuar të gjitha llojet e të hyrave që ka krijuar gjatë vitit, shpenzimet, si dhe rezultatin financiar.

**Tabela 3: Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve më 31 dhjetor 2017**

në €

<b>Përshkrimi</b>	<b>Viti 2017</b>	<b>Viti 2016</b>
Të hyrat nga subvencionet	175,288	201,423
Të hyrat nga grantet	504,532	504,465
<b>Gjithsejtë të hyrat</b>	<b>680,362</b>	<b>705,888</b>
Pagat mëditje dhe kontribute pensionale	126,871	124,358
Shpenzimet e zhvlerësimit	504,465	506,536
Shpenzimet tjera operative	49,026	74,994
<b>Gjithsejtë shpenzimet</b>	<b>680,362</b>	<b>705,888</b>
<b>Fitimi/Humbja para tatimit</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
Tatimi në fitim	0	0
<b>Fitimi/Humbja neto</b>	<b>0</b>	<b>0</b>

---

**Çështja 3 - Procedurat e rekrutimit nuk ishin në pajtueshmëri me rregullat dhe procedurat për themelimin e marrëdhënies së punës**

- E gjetura** Sipas udhëzimit administrativ nr. 14/2011 për rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, kërkohet që komisioni i rekrutimit të përbehet nga pesë anëtarë. Aeroporti kishte formuar komision për rekrutim i cili kishte vetëm tre anëtar në përbërjen e tij. Gjithashtu udhëzimi i lartë përmendur kërkon që në rast se nuk i plotësojnë kriteret e konkursit së paku tre kandidat, konkursi duhet të rishpallet. Aeroporti nuk e ka ri-shpallur konkursin edhe pse vetëm njëri nga tre kandidatet e plotësonte kriterin e përvojës, por vazhduan me procedura duke e zgjedhur kandidatin që kishte plotësuar kriteret në pozitën e përgjegjës të sigurimit. Kjo për shkak të mungesës së mbikëqyrjes së duhur nga menaxhmenti.
- Rreziku** Komisioni i rekrutimit jo në përputhje me udhëzimin administrativ dhe vazhdimi i procesit të rekrutimit pa plotësimin e kriterëve të konkursit së paku nga tre kandidat rrezikon të punësoj punonjës jo kompetent për atë vend pune.
- Rekomandimi 3** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që procedurat e rekrutimit zhvillohen në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara në konkurs dhe me udhëzuesin administrativ për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

**Çështja 4 - Raporti i pranimit nuk ishte në përputhje me sasinë e ofruar sipas faturës**

- E gjetura** Raporti i pranimit të mallit duhet të përfshijë mallin e pranuar në aspektin sasior dhe cilësor duke qenë në pajtueshmëri me kushtet e përcaktuara me kontratë në sasi dhe vlerë. Në një rast kemi identifikuar se raporti për pranim të mallit nuk ishte në përputhje me sasinë e ofruar sipas faturës, ku tre nga artikujt (5 adaptera, kablllo të UTP 100 metra dhe kutia plastike & siguresa), të përfshirë në faturë nuk janë të përfshirë në raport të pranimit, vlera e tyre ishte 134€. Kjo si pasojë e mos funksionimit të duhur të sistemit të kontrollit të brendshëm gjatë pranimit të mallit respektivisht faturës.
- Rreziku** Mos përputhja e numrit të artikujve të blerë në mes të raportit të pranimit me ato në faturë, rrit rrezikun e pagesave për artikujt e mallrave të pa pranuar.
- Rekomandimi 4** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që janë marrë masat për forcimin e kontroleve të brendshme që pagesat të bëhen vetëm sipas mallit/shërbimit të pranuar në aspektin sasior dhe cilësor.

---

**Çështja 5 – Humbjet e asetëve për shkak të mungesës së sigurisë së mjaftueshme të pasurive që janë në menaxhimin e Aeroportit**

- E gjetura** Sipas nenit 8 të statutit, Aeroportit është përgjegjës për pronësinë, asetet, pasurinë, menaxhimin, operimin dhe mirëmbajtjen e ndërmarrjes dhe duhet të nxjerrë rregullore që përmbajnë dispozita për administrimin dhe funksionimin e ndërmarrjes. Aeroporti nuk kishte nxjerr rregullore për menaxhimin dhe ruajtjen e pasurive nga humbjet dhe dëmtimi i tyre. Bazuar në raportet e menaxhmentit ne kemi vërejtur që kishin ndodhur vjedhje dhe dëmtime të asetëve (600 metra kablo me katër fije) që ishin në posedim të Aeroportit. Kjo për shkak të masave të pamjaftueshme të kontrollit të brendshme në ruajtjen dhe sigurimin e asetëve të Aeroportit.
- Rreziku** Mungesa e nxjerrjes së një rregulloreje për menaxhimin e pasurive të Aeroportit rrit rrezikun e keq menaxhimit, keq përdorimit, dëmtimit dhe humbjes së pasurive.
- Rekomandimi 5** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që Aeroporti ka hartuar dhe miratuar një rregullore për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e pasurive dhe hapësirave të Aeroportit, që të arrihet mirë menaxhimi i pasurive dhe mbrojtja nga humbja dhe dëmtimi i tyre.

**Çështja 6 - Mungesa e programit për regjistrimin e pasurive jo qarkulluese**

- E gjetura** Regjistrat e pasurive duhet të mbahen në një program (softuer) të besueshëm ku të dhënat janë të mbrojtura nga humbja dhe nga ndërhyrjet e personave të pa autorizuar. Aeroporti nuk i kishte mbajtur regjistrat e pasurive jo qarkulluese në program (softuer) funksional dhe të sigurt për të dhënat e pasurive, por regjistrat e këtyre pasurive i kishte mbajtur vetëm në tabela të Excel-it. Kjo për shkak të mos planifikimit të duhur në kohën e blerjes së softuerit për kontabilitet që ta përfshij edhe modulën e pasurive.
- Rreziku** Mbajtja e evidencave të pasurive në Excel rritë rrezikun e humbjes së evidencave të pasurive dhe ndërhyrjeve të paautorizuara duke e rrezikuar pasurinë dhe vlerën e tyre.
- Rekomandimi 6** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që evidencat e pasurive mbahen në një program (softuer) që siguron mbrojtjen e të dhënave nga humbjet apo qasjen nga personat e paautorizuar në program, për ta rritur sigurinë e informatave dhe të pasurive.



### 3.4 Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet

Në Pasqyrat Vjetore Financiare të ndërmarrjes, kapitali është prezantuar sipas kësaj strukture:

**Tabela 4: Kapitali i Aeroportit të Gjakovës më 31.12.2017**

në €

Përshkrimi	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
<b>KAPITALI</b>	<b>25,000</b>	<b>25,000</b>
Kapitali themeltar	25,000	25,000
Fitimet/Humbjet e bartura	0	0
Fitimet/Humbja e vitit aktual	0	0

#### Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

### 3.5 Pasqyra e rrjedhës së parasë së gatshme

Pasqyra e rrjedhës së parasë jep të dhëna për ndryshimet në para të gatshme gjatë periudhave raportuese të paraqitura dhe klasifikon rrjedhën e parave që arrihet nëpërmjet aktiviteteve afariste, financiare dhe investimit. Informatat rreth rrjedhës së parave të ndërmarrjes janë të dobishme për t'i dhënë shfrytëzuesit të pasqyrave financiare një vlerësim të rrjedhës së parave.

**Tabela 5: Pranimet dhe shpenzimet e parasë së gatshme**

Përshkrimi	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
<b>Paratë neto nga aktivitetet operative</b>	<b>(200,451)</b>	<b>(210,452)</b>
Rritja e parasë	-	-
Parat e paguara furnizuesve dhe të punësuarve	(200,451)	(210,452)
<b>Paratë neto nga aktivitetet investive</b>	<b>(5,537)</b>	<b>-</b>
Rritja e parasë	-	-
Zvogëlimi i parasë (blerja e mjeteve themelore dhe aktivitete tjera investuese)	(5,537)	-
<b>Paratë neto nga aktivitetet financuese</b>	<b>200,000</b>	<b>230,000</b>
Rritja e parasë	200,000	230,000
Zvogëlimi i parasë	-	-
<b>Neto rritja / (zvogëlimi) i parasë dhe ekuivalentëve të saj</b>	<b>(5,988)</b>	<b>(19,548)</b>
Paraja në fillim të vitit 2017	69,545	49,997
<b>Paraja në fund të vitit 2017</b>	<b>63,556</b>	<b>69,545</b>

**Rekomandim**

Nuk kemi rekomandim ne ketë fushë.

### 3.6 Trajtimi i shënimeve shpjeguese

Shënimet shpjeguese, paraqesin informacion lidhur me bazën e përgatitjes së pasqyrave financiare dhe politikave kontabël, të kërkuar nga SNRF-të dhe japin informacione shtesë të cilat nuk janë paraqitur në Bilancin e gjendjes, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e rrjedhës së parasë ose pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, por janë të rëndësishme për t'i kuptuar cilëndo prej tyre.

Ndërmarrja i ka bërë shpalosjet e nevojshme për informatat e përgjithshme, politikat kontabël që i përdorë dhe ka sqaruar shumat e zërave të pasqyrës së pozitës financiare, të pasqyrës së të ardhurave gjithëpërfshirëse, gjithashtu ka shpalos nëse ka detyrime kontigjente dhe ngjarje pas datës së bilancit.

**Rekomandim**

Nuk kemi rekomandim ne ketë fushë.

---

## 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit të jashtëm për PFV-të e vitit 2016 të Aeroporti është kryer nga një kompani private e auditimit që kishte rezultuar me mohim të opinionit. Kjo për arsyet në vijim: për shkak se ndërmarrja nuk kishte një softuer për mbajtjen sipas kërkesave të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe parimit të vijimësisë. Ndërsa, në Letër për Menaxhmentin ishin prezantuar 8 (tetë) rekomandime kryesore. Aeroporti kishte përgatitur Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2017, 4 (katër) rekomandime janë zbatuar dhe 4 (katër) tjerat ishin zbatuar pjesërisht. Aeroporti ishte themeluar në vitin 2015 dhe për këtë auditimi i parë është kryer në vitin 2016.

Zbatimi i rekomandimeve të auditimit të jashtëm të vitit të kaluar si mjet kyç për përmirësimin e proceseve, nuk është marrë mjaftueshëm në konsideratë nga ana e menaxhmenti.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë trajtuar ato, shihni Shtojcën II.

---

### Çështja 7 - Zbatimi i pjesshëm i çështjeve të dala nga viti paraprak

- |                      |   |
|----------------------|---|
| <b>E gjetura</b>     | Aeroporti kishte bërë planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve të dala nga auditimi i vitit paraprak. Si rezultat kishte adresuar gjysmën e rekomandimeve të dhëna, megjithatë një pjesë e tyre ishte ende në proces të zbatimit, me theks të veçantë nuk janë zbatuar plotësisht rekomandimet që kishin të bënin me regjistrimin kontabël të pasurive dhe ruajtjen e tyre. Kjo për shkak të funksionimit jo të mjaftueshëm të kontrolleve të brendshme. |
| <b>Rreziku</b>       | Mos adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak rrit rrezikun e pranisë së vazhdueshme të mangësive të njëjta të cilat ndërlidhen me PFV dhe me kontrollet e brendshme.  |
| <b>Rekomandimi 7</b> | Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj që janë marrë të gjitha masat e nevojshme për adresimin me kohë të çështjeve të dala nga auditimi i jashtëm.  |

---

## 5 Qeverisja

### Hyrje

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë auditimi i brendshëm, procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

### Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekziston një numër i dobësive të qeverisjes në Aeroport veçanërisht në lidhje me ndarjen e detyrave. Mungesa e zyrtarit certifikues redukton nivelin e sistemit të kontrollit në realizimin e pagesave dhe rritë rrezikun e pagesave në mënyrë jo të rregullt dhe me gabime. Më tutje, caktimi i anëtarit të njëjtë në dy komisione, rrit rrezikun për pranimin e mallrave dhe shërbimeve pa i plotësuar kriteret, gjithashtu krijon ndarje jo të duhur të detyrave.

Menaxheri i departamentit të mirëmbajtjes bënte furnizimin e automjeteve me derivate nga cisterna dhe i njëjti mbante regjistrat për gjendjen e derivateve dhe gjendjen e kilometrave për vetura. Autorizimi dhe ndarja jo e duhur e detyrave dhe përgjegjësive redukton kontrollin efektiv dhe aftësinë e menaxhmentit për të monitoruar në mënyrë aktive zbatimin e autorizimit të punonjësve.

Eliminimi i dobësive të identifikuara nga auditimi i jashtëm i vitit të kaluar si mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive nuk është marrë mjaftueshëm në konsideratë nga menaxhmenti. Ky është një tregues që Aeroporti nuk kishte mundur t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe t'i forcoj kontrollet e brendshme në shumë fusha.

NJAB kishte dhënë rekomandime të rëndësishme menaxhmentit për përmirësimin e funksionimit të kontrollit të brendshëm e që është e nevojshme të zbatohen.

#### 5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) përbëhet nga drejtori i auditimit të brendshëm. NJAB kishte hartuar planin vjetor të auditimit për 2017. Hartimi i planit ishte bazuar në nivelin e rrezikut për sistemet dhe proceset e përfshira në auditim. Nga tetë auditime të planifikuara gjashtë prej tyre ishin përfunduar gjatë vitit 2017. NJAB kishte dhënë rekomandime të rëndësishme menaxhmentit për përmirësimin e funksionimit të kontrollit të brendshëm. Komiteti i auditimit ishte funksional i cili në gjashtëmujorin e parë të vitit 2017 kishte mbajtur dy takime dhe kishte shqyrtuar raportet e finalizuara nga NJAB.

---

**Çështja 8 - Njësia e auditimit të brendshëm nuk kishte hartuar planin strategjik**

- E gjetura** Njësia e auditimit të brendshëm duhet të përgatis planin strategjik dhe atë vjetor të punës. Aeroporti kishte përgatitur planin vjetor të auditimit të brendshëm, por nuk kishte arritur të përgatis një plan strategjik të auditimit të brendshëm i cili mbulon një periudhë tre vjeçare të auditimeve duke u bazuar në rreziqet dhe specifikat e ndërmarrjes. Sipas menaxhmentit të Aeroportit, kjo për shkak të mungesës së strategjisë së përgjithshme të ndërmarrjes për tu mbështetur në të.
- Rreziku** Mos hartimi i planit strategjik të auditimit mund të ndikoj në efikasitetin e NJAB dhe në ndihmën e dhënë për menaxhmentin në forcimin e kontrolleve të brendshme.
- Rekomandimi 8** Kryesuesi i Bordit përmes Komitetit të auditimit të kërkoj që NJAB të hartoj planin strategjik të auditimit dhe të bëjë azhurnimin e tij në baza vjetore.

## 5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe manxhimi i rrezikut

Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, manxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, ne kemi vërejtur se masat e aplikuara janë të dobëta dhe jo efektive dhe nuk mundësojnë një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj të gjitha problemeve operative të identifikuara.

---

**Çështja 9 - Ndarje jo e duhur e detyrave**

**E gjetura** Aeroporti kishte zbatuar një sërë kontrollesh që përfshijnë udhëheqjen dhe organizimin e aktiviteteve operacionale. Ndërkohë, që kontrollet në disa fusha nuk kanë funksionuar mirë, parregullsi janë hasur në ndarjen e detyrave. Menaxheri i departamentit të mirëmbajtjes bënte furnizimin e automjeteve me derivate nga cisterna (rezervuar) e vendosur në Aeroporti, dhe i njëjti mbante regjistrat për gjendjen e derivateve dhe gjendjen e kilometrave për vetura.

Kontrollet menaxheriale të zbatuara në sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm nuk kanë identifikuar delegim dhe ndarje të duhur të detyrave. Kjo për shkak të funksionimit jo të mjaftueshëm të kontrolleve të brendshme dhe numrit të kufizuar të punonjësve.

**Rreziku** Autorizimi dhe ndarja jo e duhur e detyrave dhe përgjegjësive redukton kontrollin efektiv dhe aftësinë e menaxhmentit për të monitoruar në mënyrë aktive zbatimin e autorizimit të punonjësve.

**Rekomandimi 9** Kryesuesi i Bordit duhet të bëjë një rishikim të rregullimeve ekzistuese të delegimit të përgjegjësive dhe llogaridhënies duke siguruar ndarje të duhur të detyrave.

**Çështja 10 Mos emërimi i zyrtarit certifikues**

**E gjetura** Sipas nenit 14 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë kompania publike duhet të ketë zyrtarin certifikues. Zyrtari certifikues është përgjegjës që të sigurojë që kushtet e zbatueshme të një kontrate publike të jenë përmbushur para bërjes ose autorizimit të pagesave sipas kontratës. Ndërmarrja nuk kishte caktuar një zyrtar certifikues për autorizimin e pagesave dhe në mungesë të tij pagesat miratohen nga Kryeshefi Ekzekutiv. Mungesa e zyrtarit certifikues ka rezultuar me mangësi në menaxhimin e shpenzimeve. Pagesat ishin bërë pa kontroll të mjaftueshëm dhe aprovimin paraprak nga zyrtari për certifikim e pagesave. Mos emërimi i zyrtarit certifikues ishte për shkak të funksionimit jo të mjaftueshëm të kontrolleve të brendshme dhe numrit të kufizuar të punonjësve në Aeroport.

**Rreziku** Mungesa e zyrtarit certifikues redukton nivelin e sistemit të kontrollit në realizimin e pagesave dhe rritë rrezikun e pagesave në mënyrë jo të rregullte dhe me gabime.

**Rekomandimi 10** Kryesuesi i Bordit duhet të marrë masat e nevojshme për plotësimin e pozitës me zyrtar certifikues konform kërkesave ligjore për të siguruar ndarje të duhur të detyrave në mënyrë që të forcoje sistemin e kontrollit të brendshëm për menaxhimin e parasë publike.

---

**Çështja 11 - Anëtari i njëjtë në komisionin e vlerësimit të tenderit dhe në komisionin e mbikëqyrjes për pranimit të mallit**

**E gjetura** Sipas udhëzuesit për prokurimin publik një anëtarë i komisionit të vlerësimit të tenderit nuk mund të emërohet edhe menaxher i projektit. Në një rast kemi vërejtur se personi i njëjtë ishte caktuar në komisionin e vlerësimit të tenderëve dhe në komisionin për mbikëqyrjen për pranimin dhe montimin e kamerave. Kjo për shkak të funksionimit jo të mjaftueshëm të kontrolleve të brendshme dhe numrit të kufizuar të punonjësve në Aeroport.

**Rreziku** Caktimi i anëtarit të njëjtë në dy komisione, të vlerësimit dhe pranimit, rritë rrezikun për pranimin e mallrave dhe shërbimeve pa i plotësuar kriteret e përcaktuara në aspektin sasior dhe cilësor, gjithashtu krijon ndarje jo të duhur të detyrave.

**Rekomandimi 11** Kryesuesi Bordit duhet të siguroj se janë duke u zbatuar kriteret e përcaktuara në udhëzuesin e prokurimit publik për ndarjen e detyrave në mes të komisioneve të ndryshme.

**Çështja 12 - Mos publikimi i dokumenteve në ueb faqen e internetit të ndërmarrjes**

**E gjetura** Neni 34.2 i Ligjit për ndërmarrjet publike, kërkon që një kopje e plotë dhe aktuale e të gjitha rregulloreve të NP-së do të publikohet dhe mbahet në një faqe në internet me qasje publike e cila mbahet nga NP-ja. Gjithashtu kërkohen të publikohen plani i biznesit, raportet tremujore, raportet vjetore dhe informata tjera të rëndësishme për publikun. Ndërsa, Aeroporti ende (deri në përfundim të auditimit datë 30.05.2018) nuk e kishte publikuar raportin vjetor për vitin 2017 për qëllime të transparencës. Shkaku i skadimit të kontratës për mirëmbajtje të ueb faqes dhe në mungesë të eksperteve të brendshëm për ta mirëmbajtur vetë.

**Rreziku** Mos publikimi i raportit vjetor të ndërmarrjes në ueb faqen e internetit të saj, krijon papajtueshmëri me kërkesat e ligjit dhe mungesë të transparencës së kërkuar.

**Rekomandimi 12** Kryesuesi Bordit duhet të siguroj mirëmbajtjen e ueb faqes së internetit të ndërmarrjes dhe që të publikohet raporti vjetor sipas kërkesave të ligjit për ndërmarrjet publike, për qëllim të transparencës ndaj publikut.

---

## Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

### Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

### Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.



---

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.


## Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme

Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
Programi i kontabilitetit	Që ndërmarrja të udhëheq (mbaj) evidencat e veta në program të kontabilitetit (softuer) sipas kërkesave të standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit dhe rregullave ligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës. Pasqyrat financiare të hartohen ne bazë të evidencave, të plota dhe të sakta.		Aeroporti i Gjakovës kishte instaluar programin e kontabilitetit, ndërsa regjistrat e pasurive i mbanë në Excel.	
Përgatitja e pasqyrave financiare	Ndërmarrja të përgatitë pasqyrat financiare duke përdorë bazën e kontabilitetin mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve si dhe zërat kontabël të njihen si aktive, detyrime , kapita neto, të ardhurat dhe shpenzimet.	Ndërmarrja ka përgatitur pasqyrat financiare mbi bazën e kontabilitetit.		
Pasqyra e pozitës financiare	Pasqyra e pozitës financiare të përpilohet sipas evidencave të sakta dhe tepricave të zërave analitik në fund të periudhës sipas kontabilitetit të dyfishtë të udhëhequr në program të kontabilitetit (softuer).		Pasqyrat e pozitës financiare është përpiluar në bazë të evidencave në fund të zëra e pasurive mbahen në Excel.	
Pasqyra gjithëpërfshirëse e të ardhurave	Që pasqyrës gjithëpërfshirëse e të ardhurave të përpilohet sipas evidencave të sakta dhe tepricave të zërave analitik në fund të periudhës sipas kontabilitetit të dyfishtë të udhëhequr në program të kontabilitetit (softuer).	Pasqyra e të ardhurave është përpiluar në bazë të zërave në fund të periudhës.		

Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare	Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare të përgatitet dhe përpilohet sipas kërkesave të paragrafit 7.3 Standardit Ndërkombëtare të Kontabilitetit për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme me besnikëri të paraqiten aktivitet operative , investuese dhe financuese të rrjedhës së parasë për periudhën përkatëse.	Në pasqyrën e rrjedhës së parasë janë paraqitur aktivitet operative, investuese dhe financuese për periudhën përkatëse.		
Pasqyra e ndryshimeve të kapitalit	Që ndërmarrja në fund të çdo viti të përgatitë pasqyrën e ndryshimeve në kapital sipas seksionit 6 të standardit ndërkombëtare të kontabilitetit për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.	Ndërmarrja kishte përgatitur pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet.		
Raporte informative	Inkurajohet NP “Aeroporti i Gjakovës” SH.A që në të ardhmen të përgatitë raporte informative për drejtimin, institucionet shtetërore dhe të interesuarit, por mbështetur në bazë të dhënave të besueshme të sakta të plota dhe me kohe. Po ashtu këtë në konsiderate rregullat e ligjit mbi kontabilitet, Raportim financiar dhe auditim për udhëheqjen e evidencave financiare në program të kontabilitetit (softuer).		Ndërmarrja kishte përgatitur raportet tremujore dhe raportin vjetore ndërsa në programin e kontabilitetit (softuer) nuk kishte të instaluar modulën për regjistrimin e pasurive.	
Udhëheqja e evidencave financiare sipas regjistrimeve të dyfishta	Për të pas evidenca të sakta të plota dhe të besueshme të ndërmerren këto veprime: Në programin e kontabilitetit të krijoj një bazë të re të të dhënave me prerje 01.01.2017, të paraqes saktë tepricat fillestare të obligimeve afatshkurtra të pasurive ( paraja e gatshme në arkë dhe në bankë , llogaritë e arkëtueshme, stoqet, aktivet materiale dhe të gjitha pasuritë tjera, të paraqesë saktë tepricat fillestare të obligimeve afatshkurtra dhe afatgjata, të paraqes tepricat fillestare të kapitali aksionar.		Ndërmarrja kishte mbajtur evidencat në programin e kontabilitetit me përjashtim të evidencës për pasuritë që mbahet në Excel.	

## Shtojca III: Letër konfirmimi

NPQ "Aeroporti Gjakoves" Sh.A



### LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2017 dhe për implementimin e rekomandimeve

**Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit**

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit (Pasqyrave) Financiar të NP Aeroporti i Gjakovës sh.a, për vitin 2017 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

znj. Vlora Gojani

Data: , Prishtinë,

25.06.2018

